

KAPITULLI 2

PËRGJEGJËSIA

Arsimi i mesëm

Pjesëmarrja, marrja e përgjegjësisë

Liria mbart përgjegjësi

“Quidquid agis, prudenter agas, et respice finem.”

[Çdo gjë që bëni, bëjeni me mençuri dhe merrni parasysh rezultatin.]

Proverb latin; origjina e pa verifikuar

2.1 Rreziku i humbjes së një miku - apo i thyerjes së një rregulli?

Ne përballemi me dilema kudo

2.2 dhe 2.3 Çfarë do të bënit ju?

Ne marrim përgjegjësi për vendimet tona

2.4 Cilat janë vlerat tona të përbashkëta?

Marrja e përgjegjësisë në një komunitet që bazohet në të drejtat e njeriut

Kapitulli 2

Përgjegjësia

Pjesëmarrja, marrja e përgjegjësisë

Hyrje për mësuesit

Marrja e përgjegjësisë - një këndvështrim që ndikon në çdo gjë

Ne përherë marrim vendime, të mëdha ose të vogla qofshin. Çfarë do të hamë sot për drekë? Do të marrim makinën, apo autobusin? Çfarë partie do të votojmë? Çfarë dua të bëj pas përfundimit të shkollës?

Në çdo vendim që kemi marrë, ne përftojmë një alternativë të caktuar dhe hedhim poshtë të tjerat. Pavarësisht nëse ne jemi të vetëdijshëm për këtë apo jo, vendimet tona ndikojnë edhe të tjerët. Çfarëdo që të vendosim dhe të bëjmë mund të vihen në pikëpyetje, pasi ka alternativa që ne mund të kishim zgjedhur.

Marrja e përgjegjësisë do të thotë të marrësh parasysh këto alternativa dhe pasojat e vendimeve tona. Në këtë drejtim, marrja e përgjegjësisë, në të vërtetë, prek çdo gjë që ne bëjmë në jetë - në sferën vetjake, në marrëdhëniet tona dhe në lidhjet me familjen, miqtë, kolegët dhe komunitetin si një i tërë.

Marrja e përgjegjësisë - një e drejtë njerëzore dhe sfidë

Kur marrim një vendim, ne ushtrojmë të drejtën tonë njerëzore të lirisë. Liria mbart përgjegjësi, por ne mundemi dhe duhet të vendosim vetë se çfarë parimesh dhe udhëzimesh duam të ndjekim. Liria do të thotë se ne jemi të vetëm në vendimin tonë dhe, për këtë arsye, marrja e përgjegjësisë mund të jetë shumë e vështirë. Deri në një farë mase, në lidhje me këtë, ekzistojnë aftësi që mund të trajtohen, kjo përbën atë që nxënësit do të zhvillojnë në këtë kapitull.

Nxënësit do të komunikojnë me njëri-tjetrin, shpesh se çfarë duhet të vendosin vetë në praktikë, duke u përpjekur të kuptojmë dilemat dhe kompleksitetin, ndryshueshmërinë, bërjen e zgjedhjeve, dhe përcaktimin e përparësive.

Një koncept konstruktivist i përgjegjësisë

Marrja e përgjegjësisë është mënyra më e mirë për të mësuar dhe kuptuar në situata konkrete, në të cilat kërkohet marrja e një vendimi. Dilemat janë veçanërisht interesante në këtë drejtim, pasi ato kërkojnë trajtim veçanërisht të kujdesshëm për pasojat e një vendimi.

Në një shoqëri të hapur, sekulariste dhe pluraliste, ne nuk mund të marrim paraprakisht të dhënë se ka një kornizë vlerash me të cilën që të gjithë do të bien dakord menjëherë, megjithëse, për stabilitetin e një komuniteti, një kornizë e tillë është e domosdoshme. Prandaj, ne duhet të komunikojmë dhe të negociojmë parimet bazë që kemi në marrjen e përgjegjësisë.

Marrja e përgjegjësisë është një sfidë dhe një proces i përhershëm i të mësuarit; në këtë drejtim, ky kapitull zbaton një koncept konstruktivist të përgjegjësisë.

Kurthe në përgjegjësinë e mësimit - dhe si duhet të shmangen

Ekzistojnë dy kurthe në përgjegjësinë e mësimit - moralizimet abstrakte dhe indoktrinimi.

Moralizim do të thotë të flasësh në lidhje me të qenit "qytetar i mirë", pa vështruar në çështje konkrete. Nxënësve u jepen mesazhe se marrja e përgjegjësive është vetëm një çështje e të

dëshiruarit ose jo. Ata nuk e mësojnë kurrë se sa e vështirë mund të jetë kjo detyrë dhe se sa e rëndësishme është të ndash mendimet për të bërë një zgjedhje.

Kurthi i indoktrinimit i referohet mësuesve që përpiqen të imponojnë një grup të caktuar vlerash. Ata nuk kanë mandat për të bërë këtë dhe çfarëdo grupi vlerash që ata zgjedhin, mund të vihen në pikëpyetje dhe të hidhen poshtë.

Për të shmangur këto kurthe, kjo kapitull është e projektuar rreth një detyrë të rëndësishme që u jep nxënësve mundësinë të marrin vendimet e tyre. Mësuesi është trajneri dhe lehtësuesi i tyre.

Nxënësit diskutojnë si të zgjidhin dilemat. Historitë e rasteve lidhen me përvojat e përditshme të nxënësve, të cilat i vendosin ata në rolin e ekspertëve.

Përgatitja e kapitullit

Ne rekomandojmë që mësuesi të kryejë të njëjtën detyrë si nxënësit (shih Fleta e punës së nxënësit 2,1-2,4 dhe materialet për mësuesit 2,1-2,3). Në këtë mënyrë, mësuesit do të kuptojnë më mirë mundësitë e të mësuarit dhe do të bëhen të vetëdijshëm për vështirësitë nxënësve të tyre. . Vetë rezultati, vendimi si të zgjidhet një dilemë, nuk është përgjigja e "drejtë", pasi në të përfshihet një element i fortë subjektiviteti që nxënësit mund të mos ta pranojnë.

Zhvillim Kompetencash: lidhja me kapitujt e tjerë në këtë vëllim

Çfarë tregon kjo tabelë

Titulli i këtij manuali, *Pjesëmarrja në demokraci*, përqendrohet në kompetencat e qytetarit aktiv në demokraci. Kjo matricë tregon potencialin e pasojave të sinergjisë midis kapitujve në këtë manual. Matrica tregon se çfarë kompetencash janë zhvilluar në kapitullin 2 (rreshti i theksuar në tabelë). Kolona i me kornizë më të theksuar tregon kompetencat e vendimmarrjes dhe veprimit politik, e theksuar për shkak të lidhjeve të ngushta me pjesëmarrjen në demokraci. Rreshtat më poshtë tregojnë lidhjet me kapitujt e tjera në këtë manual: çfarë kompetencash janë zhvilluar në këto kapitull që mbështesin nxënësit në kapitullin 2?

Si mund të përdoret kjo matricë

Mësuesit mund të përdorin këtë matricë si mjet për planifikimin e orëve të tyre EQD / EDNJ në mënyra të ndryshme.

- Kjo matricë ndihmon mësuesit të cilët kanë vetëm disa orë mësimi kushtuar EQD / EDNJ: një mësues mund të zgjedhë vetëm këtë kapitull dhe të heq të tjerët, pasi ai e di se disa kompetenca kyçe tashmë janë zhvilluar, në një masë të caktuar, në këtë kapitull, për shembull, analiza, përdorimi reflektiv i medieve dhe përgjegjësia.

- Matrica ndihmon mësuesit të përdorin pasojat sinergjike që ndihmojnë nxënësit të trajnohen në kompetenca të rëndësishme në mënyrë të përsëritur, në kontekste të ndryshme që janë të ndëlidhura në shumë mënyra. Në këtë rast mësuesi zgjedh dhe kombinon disa kapituj.

Kapitujt	Dimensionet e zhvillimit të kompetencave			Qëndrimet dhe vlerat
	Analiza dhe gjykimi politik	Metodat dhe aftësitë	Vendimmarrja dhe veprimi politik	
2. Përgjegjësia	Kuptimi i çështjeve të dilemës Analiza e pasojave të një vendimi Përcaktimi i përparësive dhe dhënia e arsyeve	Shqyrtim dhe mendim i kujdesshëm Ndarja e arsytimeve dhe kritereve për një vendim	Vendimmarrja e bazuar në informacione jo të plota Ndërgjegjësimi për rrezikun e dështimit	Ndryshimi i këndvështrimeve Njohja e interesave dhe të drejtave të të tjerëve Komuniteti i bazuar në të drejtat e njeriut
1. Identiteti	Kuptimi i ndikimit të zgjedhjeve tona për të tjerët			Ndryshimi i këndvështrimeve
4 Konflikti	Dilema e vazhdimësisë	Strategjitë e negociimit	Zgjidhje konflikti	
6 Qeverisja dhe politika	Politika - një proces i zgjidhjes së problemeve dhe zgjidhjes së konflikteve			
7 Barazia	Vlerësimi i dimensionit kulturor të demokracisë		Balancimi i të drejtave të shumicës dhe pakicës	Njohja reciproke

KAPITULLI 2: Pjesëmarrja, marrja e përgjegjësive Liria mbart përgjegjësi

Tema e mësimit	Trajnimi i kompetencave /objektivat e të mësuarit	Detyrat e nxënësve	Materialet dhe burimet	Metoda
Mësimi 1 Rreziku i humbjes së një miku apo i shkeljes së një rregulli?	Kompetenca në vendimmarrjen politike dhe të veprimit: të bërit e zgjedhjes dhe dhënia e arsyeve. Ne jemi përgjegjës për zgjedhjet që bëjmë në jetën tonë të përditshme. Konceptet e dilemës dhe përgjegjësive.	Nxënësit mendojnë për zgjedhjet e tyre në situata të përditshme dilemash dhe ndajnë arsyet e tyre.	Materialet për mësuesit 2.1 dhe 2.2. Fletët e punës së nxënësit 2.1 dhe 2.2.	Diskutim plenar. Leksion. Punë në grup.
Mësimi 2 dhe 3 Çfarë do të bënit ju?	Kompetenca në marrjen e vendimeve dhe veprimit: trajtimi i dilemave. Ne bëjmë zgjedhje të ndryshme që kanë të bëjnë me dilema. Duke bërë këtë, ne ushtrojmë të drejtën tonë njerëzore të lirisë.	Nxënësit diskutojnë raste të dilemave dhe reflektojnë për përvojën e tyre personale.	Fletët e punës së nxënësit 2.1-2.4. Materialet për mësuesit 2.2. Tabelë, lapustila. Puna në grup.	Punë në grup.
Mësimi 2 dhe 3 Çfarë do të bënit ju?	Marrja e përgjegjësive përfshin trajtimin e dilemave – grumbullim informacioni, duke marrë parasysh pasojat, përcaktimin e prioritetëve, marrjen e vendimeve.	Nxënësit diskutojnë raste të dilemave dhe reflektojnë për përvojën e tyre personale.	Fletët e punës së nxënësit 2.1-2.4. Tabelë, lapustila.	Puna në grup.
Mësimi 4 Cilat janë vlerat e përbashkëta?	Gjykimi: reflektimi për kriteret dhe vlerat. Një komunitet demokratik mbështetet për një grup vlerash të përbashkëta. Të drejtat e njeriut japin një sërë vlerash me të cilat ne mund të biem dakord.	Nxënësit zgjedhin raste dilemash, raportojnë vendimet e tyre, i krahasojnë dhe diskutojnë për përparësitë e tyre.	Materialet për mësuesit 2.2 Tabelë (e përgatitur në mësimin e mëparshëm), lapustila. Broshura e nxënësit 2.5; ose si alternative, UDHR, Neni 1 në tabelë ose fletë transparente.	Diskutimi i përbashkët planifikimi. Prezantim Diskutim

Mësimi 1

Rreziku i humbjes së një miku apo i thyerjes së një rregulli? Ne përballemi me dilema kudo

<p>Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimi.</p> <p>Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD / EDNJ.</p> <p>Objektivi i mësimi tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.</p> <p>Detyra e nxënësit, së bashku me metodën, formojnë bërthamën e procesit mësimor.</p> <p>Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimi.</p> <p>Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.</p>	
Trajnimi i kompetencës	Kompetenca në vendimmarrjen dhe veprimin politik: duke bërë zgjedhje dhe duke i mbështetur ato.
Objektivat e të mësuarit	Ne jemi përgjegjës për zgjedhjet që bëjmë në jetën tonë të përditshme. Konceptet e dilemës dhe përgjegjësisë.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit mendojnë për zgjedhjet në situatat e përditshme të dilemës dhe japin arsyet e tyre.
Materialet dhe burimet	Materiale për mësuesit 2.1 dhe 2.2. Fletët e punës së nxënësit 2.1 dhe 2.2.
Metoda	Diskutim plenar, leksion, punë në grup.
Koha në dispozicion	1. Nxënësit merren me një dilemë të përditshme. 10 min
	2. Nxënësit njihen me mjetin e analizës së dilemës. 20 min
	3. Nxënësit ndajnë vendimet e tyre në dilemën provë të shkollës. 10 min

Informacion

Ky mësim i njeh nxënësit me rëndësinë dhe domosdoshmërinë e marrjes së përgjegjësisë. Në një gjyq të simuluar, ata zbatojnë mjetin për të reflektuar për vendimet e tyre në marrjen e përgjegjësisë dhe njihen me konceptin kyç të dilemës.

Të gjithë nxënësit përfshihen menjëherë në mënyrë aktive përmes qasjes induktive. Brenda pak minutash, të gjithë nxënësit në klasë janë duhet të mendojnë rreth zgjidhjes së një dileme që është e njohur për ta nga përvoja në shkollë.

Mësimi i parë ka të bëjë me temën kryesore: përballja me dilema, të bërit e zgjedhjes, reflektimi për përparësitë e përfshira në këto zgjedhje. Mësimet e mëposhtme, në vend të shtimit të temave të tjera, eksplorojnë temën e zgjidhjes së dilemave. Ashtu sikundër të gjitha kapitujt në këtë manual, edhe ky kapitull ndjek parimin didaktik të trajtimit të plotë të një pjesë të zgjedhur të lëndës - "Bëj më pak, por bëj atë mirë". Arsyeja për zgjedhjen e një sasive kaq të pakët dhe lënia jashtë aq shumë, është përvoja e bollshme që ekziston në këtë fushë. Është pikërisht intensiteti i përpjekjeve të mësuarit që jep rezultatet më të pasura, jo mbulimi i një sasive të madhe informacioni.

Përshkrimi i mësimit

Faza 1: Nxënësit mendojnë për zgjedhjet e tyre në situata të përditshme

Materiale për mësuesit 2.1

Mësuesi shpall fillimin e kapitullit të ri dhe në hyrje tregon historinë e mëposhtme.

Imagjiloni situatën e mëposhtme. Në klasën tuaj, po zhvillohet një test me shkrim në histori. Ju jeni një nga nxënësit më të mirë të klasës në histori dhe madje edhe ju mendoni se ky test është mjaft i vështirë.

Miku juaj ju pëshpërit nga prapa dhe pyet për t'i treguar testin tuaj. Ju e dini se kopjimi në test është i ndaluar, dhe të dy ju dhe shoku juaj mund të ndëshkoheni rëndë në se e bëni.

Çfarë do të bëni? A do të rrezikoni të humbisni një mik - apo do të shkelni një rregull?

Mësuesi shkruan fjalën “dilemë” - temë e këtij mësimi - në dërrasën e zezë ose në tabelë.

Ai i bën nxënësit të vetëdijshëm se përgjigja e tyre duhet të jetë po ose jo - nuk ka alternativë ose zgjidhje të ndërmjetme, as nxënësit nuk mund të komunikojnë. Më tej kërkon për një votim me duar. Nxënësit votojnë dhe mësuesi regjistron rezultatet në dërrasën e zezë ose në tabelë.

Një raund diskutim ndjek më vonë. Nxënësit japin arsyet e tyre, dhe pas disa minutave mësuesi përmbledh pikat në dërrasë. Ne mund të presim argumente si në vijim:

A do të rrezikoni të humbisni një mik - apo më mirë të thyhet rregulli?	
PO (vota x)	JO (vota y)
Miqtë e mirë e ndihmojnë gjithmonë njëri-tjetrin Edhe unë do të kem një ditë nevojë për ndihmë nga miqtë. Ne kemi nevojë për ndihmë nga njëri-tjetri. Ndryshe do të kemi një botë të ftohtë jomiqësore në të cilën askush nuk do kujdeset për të tjerët ...	Mashtrimi është i padrejtë për ata që zbatojnë rregullat. Duke mashtruar rrezikoj të dënohem edhe vetë. Miqtë nuk duhet të presin këtë nga njëri-tjetri. Varet nga miku sa i madh është rreziku. Unë mund t' flas një miku të mirë, dhe ai do ta respektojë vendimin tim. ...

Faza 2: Nxënësit prezantohen me mjetin e analizës së dilemës

Fletët e punës së nxënësit 2.1 dhe 2.2

Mësuesi shpërndan Fletët e punës së nxënësit 2.1 dhe 2.2 për nxënësit dhe prezanton konceptin dilemë (fleta 2.1) në një leksion të shkurtër. Argumentet që nxënësit kanë përdorur përshkruajnë një konflikt besnikërie: ose të qëndrojnë besnik ndaj miqve të mi kur më kërkojnë ndihmë ose të ndjek rregullat, sepse ato garantojnë shanse të barabarta për të gjithë në një test shkolle. Arsyet që nxënësit kanë dhënë dhe pritjet që të japin lidhen me vlerat: kuptimi im për miqësinë, besnikëria, gatishmëria për të ndihmuar të tjerët, drejtësia, respektimi i rregullave dhe ligjeve.

Tani unë përballem me një situatë në të cilën unë do të shkel një nga këto lidhje të besnikërisë, dhe vlerat në themel të saj - ose rrezikoj të humbas një mik dhe reputacioni im mund të dëmtohet, ose unë rrezikoj dënim dhe mund të më vrasë ndërgjegja, sepse unë theva një rregull të cilin, në fakt, e mbështes. Kjo lloj situatë, në të cilën ju mund të zgjidhni vetëm që të bëni keq, në vend që të bëni çdo gjë drejt, quhet dilemë. Ky shembull është tipik për shumë dilema:

- Nuk ka kompromis të mundshëm. Ju duhet të përcaktoni përparësitë tuaja.
- Koha ju bën presion që të veproni menjëherë. Kjo e bën të vështirë shqyrtimin me kujdes të vendimit tuaj.

- Ju nuk mund të ndryshoni vendimin tuaj më vonë, kështu që pasojat e tij janë të pakthyeshme.
- Ju merrni përgjegjësi - të dy ju dhe të tjerët duhet të përballeni me pasojat.

Në jetën tonë të përditshme, si dhe në marrjen e vendimeve politike, ne vazhdimisht përballemi me dilema. Trajtimi i dilemave të tilla është i vështirë, për shkak se çështjet, shpesh herë, janë të komplikuar dhe ne duhet të veprojmë nën presionin e kohës.

Megjithatë, zgjidhja e disa çështjeve dhe reflektimi për përgjegjësitë tona është, në një masë të caktuar, një aftësi që mund të trajnohet. Trajnimi zhvillohet me lëvizje të ngadalta. Ne zhvillojmë disa mësim rreth trajtimit të dilemave që duhet të zgjidhen menjëherë në situatat e jetës reale.

Fleta e punës së nxënësit 2.2 na ofron një mjet ndihmës për trajtimin e dilemave. Nxënësve u jepet detyra e përdorimit të këtij mjeti për çështjen e testit të shkollës. Për 5 deri 10 minuta, nxënësit duhet të zgjedhin mes një dhe tri çështjeve të cilat ata i mendojnë të rëndësishme dhe të dobishme, për t'i analizuar me kujdes. Ata duhet të marrin një vendim dhe të diskutojnë arsyen e tyre në raundin plenar që do të vijojë më pas. Ata punojnë në grupe prej tre ose katër veta.

Faza 3: Nxënësit ndajnë vendimet e tyre për dilemën e testit shkollor

Në raundin përmblyës plenar, folësit e grupit paraqesin vendimet e grupeve të tyre dhe përparësitë që çuan në to. Mësuesi drejton seancën dhe i kushton vëmendje të veçantë zgjedhjes së nxënësve për pyetjet dhe kriteret.

Për të përfunduar mësimin, mësuesi komenton në këtë pikë, duke i bërë nxënësit të vetëdijshëm për përparësitë e tyre të përbashkëta ose të ndryshme. Në fakt, duke menduar për përparësitë që udhëhoqën vendimet e tyre nxënësit marrin përgjegjësi.

Mësimet 2 dhe 3

Çfarë do të bëni?

Ne marrim përgjegjësi për vendimet tona

<p>Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.</p> <p>Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD / EDNJ.</p> <p>Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.</p> <p>Detyra e nxënësit, së bashku me metodën, formojnë bërthamën e procesit mësuesor.</p> <p>Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.</p> <p>Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.</p>	
Trajnimi i kompetencës	Kompetenca në marrjen e vendimeve dhe veprimet: trajtimi i dilemave.
Objektivat e të mësuarit	Ne bëjmë zgjedhje të ndryshme që kanë të bëjnë me dilema. Duke bërë këtë, ne ushtrojmë të drejtën tonë njerëzore të lirisë. Marrja e përgjegjësisë përfshin trajtimin e dilemave - mbledhjen e informacionit, marrjen parasysh të pasojave, përcaktimin e prioritetëve, marrjen e vendimeve.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit diskutojnë raste të dilemave dhe të reflektojnë për përvojën e tyre personale.
Materialet dhe burimet	Fletët e punës së nxënësit 2.1-2.4. Materiale për mësuesit 2.2. Tabelë, lapustila.
Metoda	Punë në grupe
Koha në dispozicion	1. Mësimdhënësi paraqet detyrën kryesore të njesisë. 10 min
	2. Detyra kyç: nxënësit diskutojnë dilemat. 70 min

Informacion

Marrja e përgjegjësisë në komunitetet laike demokratike ka një dimension konstruktivist: ne duhet të gjejmë si të marrim përgjegjësinë në një situatë të caktuar. Marrja e përgjegjësisë në situata dileme, shpesh nën presionin e kohës, është e vështirë, por kjo është diçka që mund të zhvillohet. Detyra kryesore e këtij kapitulli i shërben këtij qëllimi. Nxënësit ndajnë dhe diskutojnë problemet dhe zgjedhjet e përparësive në situata të dilemave. Marrja e përgjegjësisë është një çështje konkrete dhe, për këtë arsye, nxënësit merren me historitë e rasteve të katër dilemave që dallojnë në përmbajtje (shih Fletën e punës së nxënësit 2.3): marrja e përgjegjësisë për diçka që dikush tjetër duhet të ishte kujdesur, një konflikt i besnikërisë ndaj një mësuesi dhe një miku, një konflikt në mes të besnikërisë për një mik dhe detyrimit për t'iu bindur ligjit, për të vendosur për të mbështetur një projekt apo jo pa u informuar plotësisht për të.

Nxënësit përgatisin prezantimet e zgjedhjeve të tyre, duke u përqendruar në arsyetimet e tyre (shih Fletën e punës së nxënësit 2.4). Për të mbështetur këto prezantime, mësuesi përgatit tabelën e bazuar në këtë fletë pune, me një plan të përshtatur (shih Materiale për mësuesit 2.2).

Detyrat e zgjeruara të tipit projekt i japin mësuesit mundësinë për të vlerësuar nivelet e arritjeve të nxënësve për zhvillimin e kompetencave (shih fazën 3 më poshtë).

Përshkrim mësim

1. Mësuesi paraqet detyrën kryesore të njësisë

Qëllimi i këtij ushtrimi është të analizojë mënyrat për të zgjidhur dilemat dhe kriteret e përdorura për këtë. Nën kushtet e jetës reale, ne shpesh na duhet t'i marrim këto vendime në sekonda dhe, më vonë, mund të pendohemi në se nuk mundemi t'i korrigjojmë ato. Në politikë, proceset e vendimmarrjes shpesh merren edhe me dilema - me synime kontradiktore.

Në këtë detyrë të rëndësishme, nxënësit mund të studiojnë këtë proces të ndërlikuar të vendimmarrjes, si të thuash, me lëvizje të ngadaltë dhe të reflektojnë për përgjegjësinë që ata marrin kur vendosin për një dilemë, në një mënyrë apo tjetër.

Ata duhet të regjistrojnë vendimet dhe arsyet e tyre në Fletën e punës së nxënësit 2.4. Nëse ata nuk mund të bien dakord për një vendim të caktuar brenda grupit, të dy këndvështrimet duhet të regjistrohen dhe paraqiten.

Nxënësit formojnë grupe me nga 4-6 vetë. Ata emërojnë një menaxher grupi, një prezantues dhe një shkrimtar i cili do të mbështesë prezantuesin. Ata diskutojnë katër dilemat në Fletën e punës së nxënësit 2.3 duke përzgjedhur disa pyetje dhe kriteret nga kutia e mjeteve (Fleta e punës së nxënësit 2.2). Grupet janë të lirë për të diskutuar dilemat e mëtejshme nga përvoja e tyre personale apo nga politika.

2. Detyrë kyç: nxënësit diskutojnë dilemat

Nxënësit punojnë në grupe. Ata janë përgjegjës për punën e tyre, duke përfshirë çdo vendim për pushimet, detyrat e shtëpisë, kërkime për materialet etj.

3. Aktivitetet e mësuesit

Mësuesi vëzhgon punën e nxënësve. Aktiviteti i nxënësve është një mundësi për mësuesin që të vlerësojë nivelin e zhvillimit të kompetencave, bashkëpunimin dhe punën në ekip, menaxhimin e kohës, të kuptuarit e dilemave, nivelin e reflektimit, analizën dhe gjykimin politik.

Ai nuk i mbështet nxënësit, derisa ata të kërkojnë ndihmë; në raste të tilla, mësuesi nuk duhet të japë zgjidhje, por thjesht i ndihmon ata në gjetjen e një qasje të përshtatshme.

Përgatitja e mësimit 4:

- Mësuesi përgatit një grup prej gjashtë kartash prezantimi (shih materialet për mësuesin 2.2). Secila prej tyre është e përgatitur në një fletë të veçantë tabelë. Në katër prej tyre, mësuesi fut titujt e rasteve të dilemave dhe opsionet alternative.
- Mësuesi vëzhgon nxënësit dhe ndoshta edhe i pyet si ata po e përballojnë detyrën e tyre. Nëse ata e kanë të vështirë ose ndihen në limitet e tyre, mësuesi duhet ta trajtojë këtë problem në fazën e reflektimit (mësim 4, faza 3).

Mësimi 4

Cilat vlera duhet të ndajmë?

Marrja e përgjegjësisë në një komunitet me bazë të drejtat e njeriut

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD / EDNJ.

Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësuesor.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Gjykimi: reflektimi për kriteret dhe vlerat.						
Objektivat e të mësuarit	Një komunitet demokratik mbështetet në një grup të përbashkët të vlerave. Të drejtat e njeriut sigurojnë një sërë vlerash me të cilat ne mund të pajtohemi.						
Detyrat e nxënësve	Nxënësit zgjedhin çështje për studim dileme, raportojnë për vendimet e tyre, krahasojnë dhe diskutojnë përparësitë e tyre.						
Materialet dhe burimet	Materiale për mësuesit 2.2 Tabelë (e përgatitur në mësimin e mëparshëm), lapustila. Fletët e punës së nxënësit 2.5 ose Neni 1 i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut në një tabelë ose në fletë transparente.						
Metoda	Plane të përbashkëta diskutimi, prezantime, diskutime.						
Koha në dispozicion	<table border="1"> <tr> <td>1. Vendim i planifikuar i përbashkët.</td> <td>10 min</td> </tr> <tr> <td>2. Prezantime dhe diskutime.</td> <td>15 min</td> </tr> <tr> <td>3. Reflektimi për njësinë.</td> <td>15 min</td> </tr> </table>	1. Vendim i planifikuar i përbashkët.	10 min	2. Prezantime dhe diskutime.	15 min	3. Reflektimi për njësinë.	15 min
1. Vendim i planifikuar i përbashkët.	10 min						
2. Prezantime dhe diskutime.	15 min						
3. Reflektimi për njësinë.	15 min						

Informacion

Detyra kryesore u dha nxënësve mundësinë të prodhojnë shumë materiale dhe është mjaft e mundshme që kjo të jetë shumë më tepër se sa mund të diskutohet si duhet në një mësim. Prandaj, duhet të bëhet një zgjedhje. Nxënësit duhet të marrin pjesë në këtë vendim, sepse problemi dhe përgjegjësia është e tyre sa edhe e mësuesit. Një vendim i shpejtë kursen kohë për seancat e mëtejshme mësimore.

Megjithatë, në qoftë se nxënësit e vënë në dyshim nevojën e zgjedhjes së disa punëve të tyre për diskutim të mëtejshëm, vërejtjeve të tyre duhet t'u jepet përparësi. Për të shmangur zhgënjimin e nxënësve, është e rëndësishme që ata të kuptojnë se do të mësojnë më shumë nga një diskutim i plotë i një numri më të vogël zgjedhjesh se nga informacioni i shkurtër për çdo gjë të diskutuar. Klasa duhet të zgjidhë një dilemë, sepse koha dhe vëmendja e publikut janë burime të pakta - jo vetëm në menaxhimin e klasës, por edhe në jetën publike. Kontrollimi dhe vendosja e agjendës janë të domosdoshme, siç është edhe ushtrimi i pushtetit (shih Kapitullin 9 për një trajtim më të gjerë të kësaj çështje).

Kjo është një mundësi e rëndësishme e të mësuarit të menaxhimit të klasës - në mësimin e frymës së demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Sa më shpejt që të zgjedhin nxënësit se në çfarë çështje do të përqendrohen, aq më mirë do të jetë për ta. E rëndësishme është që askush të mos ndihet i pa përfillur. Nxënësit duhet të gjejnë ekuilibrin midis efikasitetit dhe drejtësisë në pjesëmarrje. Në fund, shumica do të vendosë (shih kapitullin 8 për problemin e votimit të pakicave).

Në fazën përfundimtare të reflektimit, ne sugjerojmë që vëmendja të përqendrohet në një nga dy çështjet kyçe të cilat janë gjithmonë të përfshira në marrjen e përgjegjësisë në shoqëritë e hapura: dilemat e kompleksitetit dhe stabilitetit (shih Materiale për mësuesit 2.3, modulën e leksioneve Nos 2 dhe 3.).

Dilema e kompleksitetit i referohet përvojës se marrja e përgjegjësisë është një detyrë e vështirë dhe këto vështirësi rriten sa më komplekse bëhen sistemet tona sociale. Nëse nxënësit flasin për këtë përvojë, atëherë mësuesi duhet të zgjedhë këtë temë. Nxënësit mund të kenë nevojë të inkurajohen për të pranuar rrezikun e ideve të gabuara, në vend që të përpiqen të shmangin marrjen e vendimeve.

Dilema stabilitetit i referohet përvojës se ne jemi fare vetëm kur marrin vendime dhe nuk mund ta marrim si të mirëqenë idenë se ne të gjithë mund t'i përmbahemi të njëjtave vlera themelore. Deri në çfarë mase, është e nevojshme një marrëveshje e tillë dhe si mund ta arrijmë atë? Të drejtat e njeriut na japin një sërë vlerash që kufizohen me parimin e respektimit të dinjitetit njerëzor, i cili është i pranueshëm për të gjitha besimet e mëdha fetare. Në këtë drejtim, ky është një mësim i rëndësishëm në edukimin e të drejtave të njeriut (EDNJ).

Përshkrimi i mësimit

Përgatitja

Mësuesi ka varur tabelat e prezantimit në klasë para mësimit.

Faza 1: Vendimi i Përbashkët i planifikimit

Mësuesi kryeson fazën e parë të mësimit. Ai shkon me radhë në secilin nga katër tabelat me histori të dilemave dhe qëndron në dy alternativa. Nxënësit votojnë për një nga alternativat me duart lart dhe mësuesi shënon rezultatet në tabelë.

Grupet, të cilat kanë reflektuar për përvojën e tyre personale, përmbledhin çështjen dhe paraqesin vendimin e nxënësve. Ata varin tabelat e tyre shtesë.

Mësuesi thekson se nxënësit nuk do të kenë kohë të mjaftueshme për të diskutuar të gjitha detajet e vendimeve të tyre dhe ata duhet të votojnë për një zgjedhje. Nëse nxënësit bien dakord, nuk ka nevojë për diskutime të mëtejshme.

Nëse nxënësit kanë vështirësi që të bien dakord për çështjen që do zgjedhin, mësuesi sugjeron një ose dy. Kriteret për një zgjedhje të tillë mund të jenë:

- një diskutim për një çështje që nxënësit e kanë gjetur shumë interesante;
- një vendim unanim - a ndajnë nxënësit vlera apo prioritete të caktuara?
- një vendim të diskutueshëm - a pajtohen nxënësit për vlerat apo prioritete të caktuara?
- një preferencë për përvojën personale të nxënësve.

Kriteret që zbatohen varen nga zgjedhjet e regjistruara në tabelë.

Faza 2: Prezantimet dhe diskutimet

Prezantuesit dalin përpara dhe shpjegojnë arsyet e vendimit të tyre si grup. Një anëtar i dytë i grupit mbështet prezantimin, duke bërë shënime të shkurtra në tabelë.

Të udhëhequr nga mësuesi, nxënësit krahasojnë kriteret e tyre dhe diskutojnë zgjedhjet. Mësuesi drejton diskutimin.

Rezultati i diskutimit nuk mund të parashikohet. Nxënësit mund të bien dakord ose jo për parimet e tyre për të marrë përgjegjësi në një situatë të caktuar. Pjesa e tretë në fund të tabelës mund të përdoret për të regjistruar rezultatin e diskutimit.

Faza 3: Reflektimi

Mësuesi zgjedh një nga çështjet e mëposhtme bazuar, për shembull, në vëzhgimin dhe bisedat me nxënësit gjatë detyrës kryesore. Një vendim i përbashkët me nxënësit nuk është i përshtatshëm, sepse mësuesit do t'i duhet të shpjegojë alternativat në një leksion të gjatë.

Alternativa 1: Dilema e kompleksitetit:

Nxënësit reflektojnë për vështirësitë në marrjen e përgjegjësive

Seanca plenare fillon me një raund reagimesh. Çfarë shkoi mirë, cila ishte e vështirësia?

Ne mund të presim që nxënësit të theksojnë se marrja e përgjegjësive në këtë mënyrë është e vështirë dhe konsumon kohë. Kërkesa për të kuptuar pasojat e asaj që po bëjmë, të shohim fundin *respice finem*, shpesh është e paarritshme.

Përgjigja e mësuesit është që ky kundërshtim është plotësisht i justifikuar. Por cilat janë alternativat? Për të ndaluar marrjen e vendimeve dhe përgjegjësive? Të këmbëngulim për informacion të plotë më parë?

Natyrisht, jeta vazhdon dhe ne do të duhet të marrim përsipër rrezikun e bërjes së gabimeve në vendimet tona. Por, dallimi qëndron nëse ne jemi të vetëdijshëm për rrezikun e ideve të gabuara, dhe sfidën e kompleksitetit në shoqërinë moderne (shih materiale për mësuesit 2.3, modulin leksion nr 2). Kjo është arsyeja pse arsimimi dhe trajnimi i këtij lloji, të ofruara në këtë kapitull, janë kaq të rëndësishme.

Alternative 2: Dilema e Stabilitetit:

Nxënësit reflektojnë për përvojën e tyre në dritën e të drejtave të njeriut

Mësuesi evidenton vlerat dhe përparësitë, përt të cilat nxënësit kanë ose jo dakord në diskutimet e tyre të mëparshme. Kjo të shpie në pyetjen e mëposhtme:

⇒ Cilat vlera e ndajmë?

Kjo është tema e mësimit; mësuesi e shkruan atë si titull në tabelë, në dërrasën e zezë ose një rrip letre A3 të mbërthyer në mur.

Nxënësit vlerësojnë diskutimin e tyre ashtu siç është shënuar në tabelë.

Kjo linjë reflektimi të çon në pyetjen e mëtejshme:

⇒ Me cilat vlera ne nuk pajtohemi? A përjashtojnë ato reciprokisht njëra-tjetrën?

⇒ Me cilat vlera duhet të biem dakord?

Mësuesi shpjegon se pse kjo pyetje është kaq e rëndësishme: ne varemi nga njëri-tjetrin për të marrë përgjegjësinë në të njëjtën linjë. Cilat mund të jenë këto pika të përbashkëta?

Nxënësit do të dinë ose do të kuptojnë se nuk ka besim fetar ose filozofi të etikës të cilat mund t'i pranojmë të gjithë dhe se askush nuk do të pranojë vlera të imponuara me forcë për ta. Burimi i vetëm që mundëson një sërë rregullash ose vlerash, për të cilat ne mund të pajtohemi e biem dakord, janë të drejtat e njeriut.

Mësuesi i referohet Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Neni 1:

"Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta. Ata kanë arsyetim dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymën e vëllazërimit."

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (10 dhjetor 1948), Neni 1; teksti i plotë në Fletët e punës së nxënësit 2.5.

Nxënësit e shikojnë këtë nen në Fletën e punës së nxënësit 2.5 ose mësuesi e paraqet në klasë. Vetëm ky nen mund të na çojë ne shumë larg:

- Ne kemi lindur me të drejtat e njeriut; ato janë të patjetërsueshme, askush nuk mund të na i marrë ne ato.
- Ne jemi të lirë.
- Ne jemi të barabartë.

Mësuesi sapo na ka treguar se si të lexojmë një nen të tillë - ngadalë, fjalë për fjalë. Nxënësit vazhdojnë:

- Ne kemi dinjitetin njerëzor: ne duhet ta trajtojmë njëri-tjetrin me respekt.
- Ne kemi të drejta të caktuara.
- Ne jemi të "mbujtur me arsye": ne mund të mendojmë për veten tonë.
- Ne jemi "mbujtur me ndërgjegje": ne mund të marrim përgjegjësi për vete.
- Ne "duhet të sillemi ndaj njëri tjetrit me frymën e vëllazërimit": ne duhet të marrim përgjegjësi për njëri-tjetrin, e cila përfshin kujdesin për ata që varen nga mbështetja e të tjerëve.

Mësuesi thekson se të drejtat e njeriut kanë jo vetëm një dimension vertikal - marrëdhëniet mes autoritetit shtetëror dhe qytetarit - por edhe një dimension horizontal - marrëdhëniet në mes individëve si anëtarë të një komuniteti. Ne mund t'i lejojmë vetes shumë liri dhe pluralizëm në një shoqëri civile bazuar në të drejtat e njeriut që na jep kuadrin e vlerave themelore për të cilat ne të gjithë mund të biem dakord.

Mundësi për studime më të zgjeruara

Të dy alternativat në fazën e reflektimit ia vlen të diskutohen. Në një zgjerim të këtij kapitulli mund të diskutohet çështja e dytë kryesore.

Çështja e përgjegjesisë mund të lidhet me çdo kapitull tjetër në këtë manual. Shih seksionin për referencat në fillim të këtij kapitulli.

Materiale për mësuesit 2.1

Si të përdorim mjetin për analizën e dilemës

(Fletët e punës së nxënësit 2.2): demonstrim modeli

Udhëzimi i këshillon nxënësit të zgjedhin disa pyetje dhe të mendojnë rreth tyre me kujdes. Kjo është arsyeja përse demonstrimi i modelit diskuton disa pyetje të zgjedhura, por lexuesi duhet të ndihet i lirë për të bërë zgjedhje të ndryshme, ose t'ju përgjigjur pyetjeve në mënyra të ndryshme. Në këtë demonstrim, metoda është më e rëndësishme se linja e të menduarit. Kjo është një ngam arsyet pse këtu nuk sugjerohet asnjë vendim.

Histori studimore nr 4: Cilat banane duhet të blej? (Fleta e punës së nxënësit 2.3)

1. Grumbullo informacion.

Kush është i përfshirë?

Çfarë kërkojnë ata? (Cilat janë nevojat, qëllimet apo interesat e tyre?)

Kush është i përfshirë?	Qëllimet, interesat
Unë si një klient	Të blej ushqime të lira. Të blej ushqim me cilësi të mirë
Supermarket	Të tërheq klientët. Të nxjerr fitime.
Tregti e ndershme	Të mbështes prodhuesit e vegjël të bananeve.
Prodhuesit e bananeve	Të punojnë për të mbështetur familjen. Të shesin produkte të mira. Të risin prodhimin.

Cili është problemi / dilema?

Të blej bananet më të lira?	Të blej bananet më të shtrenjta?
Blerja banane të lirë më ndihmon të kursej për qëllime të tjera. Po nuk ndihmova njerëzit në nevojë, të cilët, në një masë të caktuar, varen nga vendimet e mia më bën të ndihem keq.	Blerja banane më të shtrenjta do të ndihmojë fermerët e vegjël të bananeve Edhe blerja e ushqimeve të shtrenjtë ka kufijtë e veta.

Çfarë ka të bëjë ky rast me mua?

Unë jam i përfshirë drejtpërdrejt në tregun global. Vendimi se çfarë do të blej ka një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e të tjerëve.

Çfarë nuk dimë - çfarë nuk kuptojmë?

Unë jam i përfshirë drejtpërdrejt në tregun global. Vendimi im se çfarë blej ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e të tjerëve. Ne nuk e njohim njëri-tjetrin, por ne dimë pak për njëri-tjetrin dhe ne jemi të lidhur me atë që bëjmë.

Unë nuk e di se sa urgjentisht fermerët varen nga ndihma ime. Ndoshta klientët e tjerë kanë blerë kile të tëra banane te Tregu i Ndershëm, por edhe e kundërta mund të jetë e vërtetë.

Sa e madhe do të jetë përpjekja ime për të gjetur informacionin që mungon?

Në kushtet e jetës së përditshme, unë duhet të marr një vendim tani. Mua më nevojitet diçka për të ngrënë, kështu që unë duhet të vendos pa e ditur tablonë e plotë; ky është rregulli e jo përjashtimi.

2. Shqyrtoni pasojat.

Cilat janë zgjidhjet alternative?

Çfarë pasoja do të ketë secila prej këtyre zgjedhjeve, dhe për të cilin ...?

Zgjedhjet alternative	Alternativa 1: Blej banane të lira	Alternativa 2: Blej banane të shtrenjta
Unë si klient	Pa marrë parasysh sa të mëdha apo të vogla janë të ardhurat e mia, unë nuk do ta vë re ndryshimin. Nëse është e nevojshme, unë mundem lehtësisht ta kompensoj, duke kursyer në një hamburger ose një çokollatë. Çështja mund të jenë ndryshe në se unë jam në borxh dhe duhet të ul shpenzimet, kudo që të mundem.	
Prodhuesi Bananeve	Nuk ka mbështetje.	Mbështetje modeste, me pasoja të konsiderueshme (informacion i Tregtisë së ndershme).
Supermarketi	Ne nuk kemi shifra të sakta, por mund të hamendësojmë se supermarketi do të kenë fitime për sa kohë ne blejmë disa banane, qofshin ato të lira ose tregtuar ndershmërisht.	
Tregti e ndershme	Nuk ka sukses për Tregti të ndershme.	Suksesi për Tregti të ndershme.

3. Përcaktoni përparësitë tuaja.

Deri në çfarë mase mund t'i kuptoj unë pasojat e vendimit tim?

Unë nuk e kam të qartë të gjithë tablonë dhe nuk mund të ndërmarr veprime për ta siguruar atë, nëse nuk e bëj atë një nga përparësitë e mia kryesore. Unë duhet të vendos nëse do të mbështetem në informacionet që më janë ofruar mua nga të tjerët, në këtë rast nga Tregu i ndershëm. Ata më thonë se edhe një donacion i vogël do të thotë shumë për fermerët e bananeve në vendet në zhvillim.

Cilat parime fetare ose morale janë të rëndësishme për mua?

Kjo pyetje është me të vërtetë e një rëndësie të veçantë. Ne jemi të lirë të përgjigjemi si e mendojmë ë drejtë.

A është vendimi im i pakthyeshëm ("pikë pa kthim"), apo unë mund ta korrigjoj atë më vonë?

Ky lloj vendimi mund të merret disa herë. Unë mund të bëjë një zgjedhje sot dhe nesër të bëj një zgjedhje të kundërt. Unë mund të mendoj për vendimin tim, por unë nuk mund të rishikoj një vendim të bërë në të kaluarën.

4. Merrni vendimin tuaj.

A duhet unë të zgjedh një synim dhe të shkel të tjerët?

Po. Ju zakonisht blini banane të lira ose të shtrenjta, por jo të dyja. Një kompromis - blerja e disave nga secili - nuk është shumë bindëse.

Në kushte të dhëna, çfarë më thotë intuita ime? Me çfarë vendimi mund të identifikohem unë më shumë?

Në kushtet e jetës së përditshme, intuita jonë është ndoshta udhëzuesi ynë më i rëndësishëm, dhe shpesh është më i besueshëm se një përpjekje e madhe për të menduar. Ne bëjmë atë që mendojnë se është më e mira. Marrja e përgjegjësisë në këtë mënyrë do të thotë të përpiqesh të kuptosh, dhe nganjëherë të rishikosh atë që intuita jonë na thotë.

Materiale për mësuesit 2.2

Tabelë për krahasimin e zgjidhjeve të dilemave (mësimi 4)

Një tabelë është e nevojshme për çdo rast dileme. Sugjerime për mënyrën e shprehjes së alternative, i gjeni në Fletët e punës së nxënësit 2.4.

Rasti i dilemës:

Shto titullin nga Fletët e punës së nxënësit 2.3

Alternativat	Arsyet
<i>(Këtu vendosni variantin e dilemës së parë)</i> Grupi Nr	
<i>(Këtu vendosni variantin e dilemës së dytë)</i> Grupi Nr	
<i>(Lëreni bosh për shënime shtesë)</i> Grupi Nr	

Materialet për mësuesit 2.3

Liria dhe përgjegjësia - moduli me tre leksione

Ky është një grup leksionesh për t'u zgjedhur në përgjigje të nevojave të mësimit të nxënësve - si brenda kapitullit me katër module me leksione, ashtu edhe si një zgjerim alternativ i kapitullit. modulet shqyrtojnë kushtet e marrjes së përgjegjësisë në shoqëritë tona moderne:

Moduli 1: Të mësuarit se si të marrësh përgjegjësi është e pamundur pa marrë përsipër rreziqe.

Moduli nr 2: Si mund të jemi në të suksesshëm kur marrim përgjegjësi në shoqërinë tonë moderne, gjithnjë e më të ndërlikuara që zgjidh shumicën e kufijve tanë ekstrem?

Moduli nr 3: Stabiliteti i bashkësive demokratike ka një dimension kulturor - një grup të përbashkët të vlerave në mes të anëtarëve të tij që nuk mund të zbatohet, por me të cilin duhet të bihet dakord.

1. Dilema e rrezikut-përgjegjësisë

Zgjedhja lirisht është një e drejtë e njeriut, por kjo liri mbart përgjegjësi. Ne duhet të jemi gjithmonë të vetëdijshëm për ndikimin dhe pasojat që kanë vendimet dhe veprimet tona për veten tonë ose për të tjerët, sot dhe në të ardhmen, këtu apo diku tjetër në botë. (Shih modelin e qëndrueshmërisë në Fletën e punës së nxënësit 4.2).

Nga ana tjetër, ne vetëm mësojnë se si të marrim përgjegjësi në kushte të lirisë, e cila përfshin edhe lirinë për të dështuar. Për shembull, të rinjtë duan të dalin jashtë natën dhe në fundjavë. Prindërit e tyre presin që ata të jenë në shtëpi në një orë të caktuar dhe është përgjegjësi e të riut që t'i përmbahet marrëveshjes. Pa liri për të lëvizur lirshëm dhe për të marrë përsipër të gjitha rreziqet e përfshira, askush nuk do të mund të mësojë si të marrë përgjegjësi.

2. Kompleksiteti i dilemës - demokraci

Në këtë kapitull, nxënësit reflektojnë për atë se si të marrim përgjegjësi në situatat e përditshme. Ne shpesh duhet të vendosim në çast si të zgjidhim një dilemë. Detyra kryesore (mësimet e 2 dhe 3) i lejojnë nxënësit të analojë përmasat e përgjegjësive me lëvizje të ngadalta, dhe në këtë mënyrë, ata trainojnë intuitën e tyre. Marrja e përgjegjësive kërkon aftësi për t'u orientuar në situata komplekse në çast dhe pastaj, duke përdorur intuitën, të marrësh një vendim që do përballet me reflektimin kritik. Në përvojën tonë të përditshme, kjo është "normale" dhe ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për rrezikun e të bërit të gabimeve, kur duhet të vendosim për çështje të vështira nën presionin e kohës. Trajnimi dhe përvoja na ndihmon për të përmirësuar intuitën, por problemi mbetet.

Kompleksiteti merr cilësi të ndryshme në nivel shoqëror ose global. Për shembull, ne shpesh e kemi zgjedhjen se si do të udhëtojmë nga A në B, për shembull nga shtëpia në shkollë. Shkuarja me makinë është më e përshtatshme, ndërsa marrja e autobusit ose biçikletës zgjat më shumë, për të mos përmendur vonesat e mundshme, lagështirën në një mot me shi etj. Çfarë zgjedhje do të bëjmë? Një kriter mund të jetë makina në varësi të ndryshimeve klimatike. Por, a do mundet vetëm makina ime të bëjë një ndryshim të tillë, veçanërisht në qoftë se vetëm një pakicë merr autobusin ose biçikletën? Çështja është shumë e ndërlikuar për një individ për ta trajtuar (shih njësinë 4). E njëjta vlen edhe kur ne duhet të marrim pjesë në një debat politik për një çështje të tillë – a po bëjmë ne sa duhet ose gjërat e duhura për të shmangur ndryshimet e klimës?

Kjo rritje në kompleksitet është tipike për shoqëritë moderne. Ato janë të lidhura me tregjet globale dhe varen nga njëri-tjetri në mënyrën sesi trajtojnë çështjet globale, si për shembull, ndryshimet klimatike. Duke pasur të bëjnë me çështje komplekse, bëhet më e vështirë edhe marrja e përgjegjësive. Ky është, në një farë mënyre, çmimi që ne duhet të paguajmë për rritjen e standardit tonë të jetesës në shoqëritë moderne, për shkak të arritjeve në shkencë, teknologji dhe arsim.

Intuita nuk na ndihmon më në marrjen e përgjegjësive për çështje të tilla komplekse si ndryshimet klimatike. Ne kemi nevojë për këshilla nga ekspertët. Në demokraci, qytetarët dhe politikanët, të cilët duhet të mbështeten te ekspertët për të kuptuar botën ku jetojnë, rrezikojnë të rrëshqasin në një lloj

oligarkie moderne, post-demokratike, një sundim i ekspertëve të cilët qytetarët nuk mund t'i kontrollojnë më. Kjo është dilema e kompleksitetit-demokraci.

Demokracia qëndron dhe bie me premtimin se çdo qytetar i interesuar mund të marrë pjesë në vendimmarrje. Për të bërë këtë me përgjegjësi kërkohen qytetarë të arsimuar. Edukimi është i vetmi shans që ne kemi për të zgjidhur dilemën e kompleksitetit. Zgjerimi i edukimit nuk ka qenë vetëm një forcë shtytëse e kompleksitetit në rritjes të shoqërinë moderne, por është gjithashtu edhe çelësi për tejkalimin e dilemës kompleksitetit-demokracisë.

3. Liria-dilema e stabilitetit: liria, pluralizmi dhe nevoja jonë për disa vlera të përbashkëta

Neni 18

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, në publik ose privatisht, për të manifestuar fenë ose bindjen e tij në mësimdhënie, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.

Neni 19

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion dhe ide me çfarëdo mjeti dhe pavarësisht nga kufijtë.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (10 dhjetor 1948); teksti i plotë në broshurë e nxënësve 2.5.

Individët që ushtrojnë këto të drejta prodhojnë pluralizëm në shumë forma (shih kapitullin 3). Një nga pasojat është që njerëzit aderohet në besime të ndryshme fetare dhe sisteme të vlerave, edhe më shumë nëse kemi të pranishëm komunitete emigrantësh. Shoqëritë moderne janë laike dhe pluraliste - anëtarët e tyre të zhvillojnë qëndrime dhe identitete individuale (shih kapitullin 1). Përgjegjësia ka një dimension konstruktivist.

Nga ana tjetër, çdo komunitet mbështetet në një grup vlerash me të cilat bien dakord të gjithë anëtarët. Demokracia mbështetet, në mënyrë të barabartë, në një shtet të fortë dhe në një kulturë politike mbështetëse.

Kjo është dilema liri-stabilitet: një shtet demokratik dhe laik varet nga kushtet kulturore që institucionet dhe autoritetet e saj nuk mund t'i prodhojnë ose t'i zbatojnë. Një grup vlerash, rregullash dhe qëllimesh, të pranuar dhe vlerësuar në mënyrë kolektive, nuk mund të merret si e mirëqenë. Më saktë, është përgjegjësi e qytetarëve për të (ri) të negociuar dhe (ri) përcaktuar vlerat, rregullat dhe qëllimet e tyre. Edukimi dhe EQD/EDNJ në veçanti, luajnë një rol kyç në përmbushjen e kësaj sfide. Të drejtat e njeriut japin ndoshta të vetmen përmbledhje të rregullave dhe parimeve që mund të pranohen në mënyrë universale (shih mësimin 4 të këtij kapitulli, që fokusohet në nenin 1, DUDNJ). Të drejtat e njeriut theksojnë parimin e njohjes së ndërsjellë - rregulli i artë - por që nuk promovon ndonjë besim të caktuar fetar ose filozofi të etikës dhe të moralit. Nga ky këndvështrim, të drejtat e njeriut nuk janë vetëm burimi i problemit, por edhe çelësi për zgjidhjen.